




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Bazuar në nenin 5.2 dhe 8.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Nr.03/L-087, në nenin 39 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 16.10.2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË
AKSIONARËVE NË NDËRMARRJEN PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE
“KOSOVATRANS” NË GJILAN

I

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit emëron dy anëtarë në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen për transportin e udhëtarëve “Kosovatrans” në Gjilan, dhe atë:

1. Tefik Ibrahim, i,
2. Blerim Muji,

II

Komision Komunal i Aksionarëve si në pikën I të këtij vendimi i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni po ashtu do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore si dhe do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes për transportin e udhëtarëve “Kosovatrans” në interes të Komunës.

III

Komisioni, për punën e kryer do të kompensohet me vendim të veçantë

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik si dhe Kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-Gjilani.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit,

01.Nr. 119106
Gjilan, më 16.10.2012

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues